

**ITX ALBANIA SHPK**

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare më dhe për  
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

## **PËRMBAJTJA**

## **FAQJA**

### **RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR**

#### **PASQYRAT FINANCIARE:**

<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE</b>	<b>4</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR</b>	<b>5</b>
<b>PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE</b>	<b>6</b>
<b>SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE</b>	<b>7-30</b>

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

### Aksionarit dhe Drejtimit të ITX Albania SHPK

#### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të ITX Albania SHPK (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2018 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

#### Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar “*Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare*” të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (“BKSNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

#### Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbledhjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhe shënimet shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë

**Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)**

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania SHPK*

Deloitte Audit Albania SHPK  
Rr. Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit Gjeologji - Miniera,  
Tiranë, Shqipëri  
Numër unik i subjektit (NUIS): L41709002H



*Enida Cara*  
Auditues Ligjor  
Partner angazhimi  
Enida Cara

Tiranë, Shqipëri  
29 maj 2019

**ITX Albania SHPK****Pasqyra e pozicionit financiar***Shumat janë të shprehura në mijë LEK)*

	Shënime	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktivitet Afatshkurtra</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	5	402,536	663,947
Inventari	6	277,254	213,135
Aktive të tjera afatshkurtra	7	23,937	7,666
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>703,727</b>	<b>884,748</b>
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	8	964,399	673,810
Aktive tatimore të shtyra	9	27,544	21,556
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>991,943</b>	<b>695,366</b>
<b>Totali i Aktiveve</b>		<b>1,695,670</b>	<b>1,580,114</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrimet Afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme	10	150,260	136,100
Të ardhura të shtyra	11	32,269	29,670
Detyrime të tjera	12	78,234	73,062
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>260,763</b>	<b>238,832</b>
<b>Detyrimet Afatgjata</b>			
Të ardhura të shtyra	11	310,180	304,118
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>310,180</b>	<b>304,118</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>570,943</b>	<b>542,950</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali aksionar		400,000	400,000
Fitimi i vitit		724,727	637,165
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>1,124,727</b>	<b>1,037,165</b>
<b>Totali i kapitalit dhe i detyrimeve</b>		<b>1,695,670</b>	<b>1,580,115</b>

*Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 deri në 30, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.*

**ITX Albania SHPK****Pasqyra e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse***(Shumat janë shprehur në mijë LEK)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga shitjet	13	3,294,850	3,061,681
Kosto e mallrave të shitur		1,635,297	1,480,868
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>3,294,850</b>	<b>3,061,681</b>
<b>Shpenzime</b>			
Shpenzime personeli	15	(175,127)	(164,142)
Shpenzime page		(152,463)	(143,424)
Shpenzime sigurime shoqërore dhe shëndetësore		(22,664)	(20,718)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	8	(115,113)	(109,037)
Shpenzime të tjera operative	16	(518,097)	(480,343)
Të ardhura të tjera	14	31,539	30,276
<b>Të ardhura/(Humbje) nga aktiviteti operativ</b>		<b>858,500</b>	<b>757,622</b>
Humbje nga kursi i këmbimit	17	(4,249)	(4,423)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>854,251</b>	<b>753,199</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	18	(129,524)	(116,034)
<b>Fitimi neto</b>		<b>724,727</b>	<b>637,165</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse</b>		<b>724,727</b>	<b>637,165</b>

*Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 deri në 30, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.*

**ITX Albania SHPK****Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar**  
(Shumat janë të shprehura në mijë LEK)

	Kapitali i regjistruar dhe i paguar	Humbjet e akumuluar	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2017</b>			
Dividend të paguar	400,000	564,745	964,745
Fitim i vitit	-	(564,745)	(564,745)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	637,165	637,165
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>		637,165	637,165
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>400,000</b>	<b>637,165</b>	<b>1,037,165</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2018</b>			
Dividend të paguar	400,000	637,165	1,037,165
Fitim i vitit	-	(637,165)	(637,165)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	724,727	724,727
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>		724,727	724,727
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>400,000</b>	<b>724,727</b>	<b>1,124,727</b>

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit aksionar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 deri në 30, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar dhe firmosur më 23 maj 2019 nga:

**Ana Rogic**

Administrator

**Jonida Shahu**

Manaxhere financiare





**ITX Albania SHPK**  
**Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare**  
*(Shumat janë shprehur në mijë LEK)*

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaria e shfytëzimit</b>		
Fitimi neto para tatimit	854,251	753,199
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimin dhe amortizimin e aktiveve afatgjata	115,113	109,037
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve	26	-
Efekti i kursit të këmbimit mbi mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në monedhë të huaj	(4,249)	(4,423)
<i>Ndryshimet në kapitalin punues:</i>		
(Rritje) /Rënie në llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	(16,271)	1,855
Rritje në inventar	(64,119)	(20,997)
Rritje/(Rënie) e të ardhurave të shtyra	8,661	(29,671)
Rritje në llogaritë e pagueshme dhe të tjera	19,332	34,517
Tatim fitimi i paguar	(135,512)	(121,782)
<b>Fluksi i mjete monetare neto gjeneruar nga veprimtaritë e shfytëzimit</b>	<b>777,232</b>	<b>721,735</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet investuese</b>		
Blerje aktivesh afatgjata materiale	(405,727)	(33,171)
<b>Flukse monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese</b>	<b>(405,727)</b>	<b>(33,171)</b>
<b>Flukse monetare nga veprimtaritë financuese</b>		
Pagesa e dividendëve	(637,165)	(564,745)
<b>Fluksi i mjete monetare neto përdorur në veprimtaritë financuese</b>	<b>(637,165)</b>	<b>(564,745)</b>
<b>Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre</b>	<b>(265,660)</b>	<b>123,819</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	663,947	535,705
Efekti i kursit të këmbimit mbi mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në monedhë të huaj	4,249	4,423
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit</b>	<b>402,536</b>	<b>663,947</b>

*Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 deri në 30, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.*

## **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

ITX Albania Sh.p.k. ("Shoqëria") u krijua si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 27 nëntor 2013. Vendndodhja kryesore e aktivitetit është në Tiranë, Shqipëri. Shoqëria zotërohet 100% nga Zara Holding BV ("shoqëria mëmë"). Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 100 aksione me vlerë 4,000,000 LEK secili. Përfaqësuesi ligjor i kompanisë më 31 dhjetor 2018 është Ana Rogic.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është shitja e produkteve të modës nëpërmjet dyqaneve me pakicë. Shoqëria aktualisht po manaxhon gjashtë dyqane të markave të ndryshme: Zara, Zara Home, Bershka, Stradivarius, Pull & Bear dhe Massimo Dutti, të cilat ndodhen në qendrën tregtare Tirana East Gate ("TEG") në Lundër, Tiranë, Shqipëri. 5 dyqane janë hapur që nga data 16 prill 2014. Tre dyqane të reja janë hapur në shtator 2018: Zara Home në Tirana East Gate ("TEG") dhe Bershka dhe Stradivarius në Qendrën Tregtare Univers ("QTU").

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është Rruga "Dervish Hima", Ndërtesa "Ambassador 3".

Më 31 dhjetor 2018, Shoqëria kishte 271 punonjës (31 dhjetor 2017: 234 punonjës).

## **2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

#### **a) Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe paraqitur në Lekë, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

#### **b) Parimi i vijimësisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, e cila supozon se Shoqëria do të jetë në gjendje të realizojë aktivet e saj dhe të kryejë detyrimet e saj në rrjedhën normale të biznesit. Shoqëria bazohet në këtë supozim duke marrë parasysh pozicionin financiar të shoqërisë mëmë, objektivat aktuale, rentabilitetin e operacioneve dhe aksesin në burimet financiare.

## **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**

Politikat kryesore janë renditur më poshtë.

### **a. Aktive Afatgjata Materiale**

#### *(i) Njohja dhe vlerësimi*

Aktivitet Afatgjata Materiale janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar. Kosto e tillë përfshijnë shpenzimet që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktiveve.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **a. Aktive Afatgjata Materiale (vazhdim)**

Kostot për ndërtimin vetë të një aktivi përfshijnë kostot për materialet dhe mjetet e përdorura në ndërtimin e aktivit, kostot e punës (pagat, tatimet dhe kontributet përkatëse paguar punonjësve në lidhje me ndërtimin e aktivit) dhe çdo kosto e drejtpërdrejtë e nevojshme për ta sjellë aktivin në kushtet e nevojshme për funksionimin e tij.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit i një zëri të aktiveve afatgjata përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël të aktivit dhe njihen neto në të ardhurat e tjera në pasqyrën e të ardhurave.

##### *(ii) Kostot vijuese*

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme dhe kostot e zëvendësimit të një pjese të aktivit i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato marrin pjesë në gjenerimin e përfitimeve të ardhshme ekonomike për shoqërinë. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen në pasqyrën e humbje/fitimit kur ato ndodhin.

##### *(iii) Amortizimi*

Vlera e amortizueshme e një zëri të AAM-së njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke përdorur metodën lineare për të gjitha aktivet materiale mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë që prej ditës së parë të muajit pasues të muajit të blerjes.

Normat e amortizimit të përdorura nga shoqëria janë si më poshtë:

<b>Kategoria e Aktiveve</b>	<b>Metoda e amortizimit</b>	<b>Norma e amortizimit 2018</b>	<b>Norma e amortizimit 2017</b>
Mobilje dhe Instalime	Metoda lineare	9.5%	10%
Pajisje Elektronike	Metoda lineare	20.00%	20.00%
Përmirësimet e objekteve me qira të lidhura me dyqanet	Metoda lineare	9.5%	10%
Përmirësimet e objekteve me qira në lidhje me zyrën	Metoda lineare	9.5%	35.23%

Vlera e mbetur, jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit, rishikohen dhe rregullohen kur është e përshtatshme, në çdo vit financiar. Ndryshimet në metodën e amortizimit do njihen si ndryshime në rregullat e kontabilizimit.

#### **b. Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale**

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale, zvogëlohet deri në shumën e rikuperueshme të aktivit, nëse kjo shumë është më e ulët se vlera e tij kontabël. Për të përcaktuar nëse një aktiv mund të ketë rënë në vlerë, kryhet një test, nëpërmjet të cilit vlerësohet shuma e rikuperueshme.

Një test zhvlerësimi kryhet në çdo datë të bilancit për aktivet që tregojnë shenja të rënies në vlerë. Testi i zhvlerësimit kryhet me qëllim që të përcaktohet shuma e rikuperueshme e një aktivi afatgjatë, e cila është shuma më e lartë midis vlerës së drejtë të një aktivi afatgjatë (minus koston e shitjes) dhe vlerës në përdorim të tij. Vlera kontabël neto e aktivit reduktohet nëse si vlera e tij e drejtë (minus koston e shitjes) ashtu edhe vlera në përdorim janë më të ulëta se vlera e tij kontabël.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **b. Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata (vazhdim)**

Nëse ka shenja që shuma e rikuperueshme e një aktivi afatgjatë është rritur rmbi vlerën kontabël, humbja e mëparshme nga zhvlerësimi rimerret dhe vlera kontabël e aktivitet rritet. Kufiri më i lartë i rritjes është vlera e mëparshme kontabël e aktivitet afatgjatë minus amortizimin gjatë viteve të ndërmjetme, sikur të mos ishte njohur më parë rënie në vlerë.

Rimarrja e një rënie në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën raportuese, si një pakësim i humbjes nga zhvlerësimi.

#### **c. Ç'regjistrimi**

Një aktiv afatgjatë material ç'regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo kur nuk priten më përfitime të ardhurave ekonomike nga përdorimi apo nxjerrja jashtë përdorimit e tij. Çdo fitim ose humbje që vjen nga ç'regjistrimi i aktivitet (përcaktuar si diferencë mes arkëttimeve të shitjes dhe vlerës së mbetur të aktivitet) njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivi ç'regjistrohet.

#### **d. Inventarët**

Inventarët maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Vlera neto e realizueshme i referohet çmimit të shitjes që Shoqëria pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit, minus të gjitha kostot e vlerësuara për ndërlikimin e biznesit.

#### **e. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre dhe llogaritë e pagueshme dhe të tjera. Instrumentat financiarë jo-derivativë maten fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat që nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, çdo kosto të transaksioneve që janë direkt të atribueshme, përveç çfarë përkrahur më poshtë. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare jo-derivativë maten si më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë ç'regjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë në rrjedhën e parasë nga aktivitet financiarë skadojnë ose nëse Shoqëria ia transferon aktivitet financiarë një pale tjetër pa ruajtur kontrollin ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitet.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare rregjistrohen në datën e tregtimit, p.sh. data në të cilën Shoqëria angazhohet të shesë apo të blejë aktivin. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të përcaktuara në kontratë skadojnë ose anulohen.

#### *Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga vlera në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat bankare me maturitet tre muaj ose më pak nga data e lidhjes së kontratës. Ekuivalentët e parasë përfshijnë investime afatshkurtra, shuma likuide, të cilat janë lehtësisht të konvertueshme në para dhe kanë një rrezik minimal, përta i përket ndryshimit të vlerës së drejtë.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **e. Instrumentat financiarë (vazhdim)**

##### *Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me kosto minus humbje nga zhvlerësimi, nëse ka. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme krijohet kur ka të dhëna objektive që Shoqëria nuk është e aftë të mbledhë të gjitha shumat për t'u arkëtuar sipas kushteve fillestare. Kostoja e amortizuar e llogarive dhe kërkesave të arkëtueshme afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provigjionet e krijuara për rënie në vlerë).

##### *Detyrimet Financiare*

Detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë të shumës për t'u paguar, duke përfshirë detyrimet për interesin e pagueshëm në periudhat e ardhshme, me metodën e normës së interesit efektiv. Detyrimet financiare mbahen në vazhdim me koston e amortizuar.

##### *Metoda e interesit efektiv*

Metoda e interesit efektiv është një metodë për llogaritjen e koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe e shpërndarjes së shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma që skanton rrjedhat e ardhshme të pagesave gjatë kohëzgjatjes së parashikuar të detyrimit financiar ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Shoqëria vlerëson në çdo datë të mbylljes së bilancit, nëse ka të dhëna që një aktiv financiar ose grup aktivesh financiare është zhvlerësuar. Nëse rezulton diçka e tillë, atëherë aktivi financiar i mbajtur me koston e amortizuar, zvogëlohet deri në vlerën aktuale të flukseve të përlogaritura të ardhshme të parasë (të skontuara me normën e interesit efektiv fillestar të aktivitetit financiar). Humbjet nga zhvlerësimi i aktivitetit financiar njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Informacioni objektiv, që një aktiv ose grup aktivesh ka rënë në vlerë, përfshin të dhëna të vëzhgueshme për ngjarje si: vështirësi të mëdha financiare të huamarrësit, mosrespektim i kontratës (p.sh. rasti i dështimit ose i vonës në pagimin e interesave dhe të principalit); falimentimi dhe ristrukturime të tjera financiare të huamarrësit

Zhvlerësimi i aktiveve financiare, individualisht të rëndësishme, vlerësohet veçmas për secilin aktiv. Aktivitetet financiare, të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht dhe për të cilat nuk ka të dhëna për zhvlerësim, vlerësohen në mënyrë kolektive për ndonjë rënie në vlerë.

Humbja nga rënia në vlerë mund të anulohet nëse anulimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi është njohur humbja nga zhvlerësimi. Rimarja e humbjes nga zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### *Ç'regjistrimi*

Një aktiv financiar ç'regjistrohet kur Shoqëria humbet të drejtën mbi flukset e parave të aktivitetit financiar ose transferon të drejtën për të marrë flukset e parave që vijnë nga aktivi financiar në një transaksion në të cilën transferohen gjithashtu edhe të drejtat dhe rreziqet e pronësisë së aktivitetit financiar. Me ç'regjistrimin e një aktiviteti financiar, diferenca mes vlerës kontabël të aktivitetit financiar dhe shumës së arkëtuar për të njihet në fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shoqëria ç'regjiston një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë. Një detyrim financiar shkarkohet kur paguhet ose i transferohet me kontratë një pale tjetër. Një detyrim financiar anulohet vetëm nëse pala tjetër e anulon atë. Një detyrim financiar skadon në datat e paraqitura në legjislacionin përkatës. Diferenca mes vlerës kontabël të detyrimit financiar dhe shumës së paguar për të njihet në fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **f. Transaksionet në monedhë të huaj**

Fitimi ose humbja nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj është diferenca që rezulton nga një numër i dhënë njësisish të një monedhe të huaj në Lekë me kurse këmbimi të ndryshëm. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetarë të shprehura në monedhë të huaj përkthehen në Lekë me kursin e këmbimit të datës së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerën e drejtë ripërkthehen në Lekë me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Fitimet ose humbjet që vijnë nga ndryshimet e kursit të këmbimit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit zyrtarë për monedhat kryesore të përdorura në përkthimin e zërave të bilancit kontabël të cilat shprehen në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si më poshtë (Leku ndaj kurseve të huaja të këmbimit):

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
1 EUR	123.42	132.95
1 USD	107.82	111.10

#### **g. Provigjonet**

Provigjoni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose strukturor dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohet një dalje burimesh e shprehur me përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, e cila mund vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provigjonet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim.

#### **h. Të ardhurat dhe shpenzimet**

Të ardhurat nga shitja vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e zbritjeve të ofruara dhe taksave të lidhura me shitjet. Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur Shoqëria i ka kaluar bleresit të gjitha risqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e mallrave, kur është i mundur kthimi i shumës, kur shpenzimet e bëra në lidhje me transaksionin dhe kthimet e mundshme të mallrave mund të maten me besueshmëri, kur Shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. Transferimi zakonisht ndodh kur produkti i kalon klientit në pikën e shitjes. Shoqëria njih si shpenzim çdo shtesë të rezervave për provigjione kundrejt rreziqeve, humbjeve, dëmtimit fizik ose kthimeve të mundshme që njihen në datën e pasqyrave financiare.

#### **i. Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat mbi fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kursi i këmbimit. E ardhura nga interesi njihet kur ai përfitohet, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë e marra, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktivitetit financiar nëpërmjet fitimit ose humbjes (nëse ka), dhe humbjeve nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Të gjitha kostot e huasë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### **j. Shpenzimi i tatimit mbi fitim**

Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm ose arkëtueshëm mbi fitimin/(humbjen) e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdo lloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Shoqëria ka zgjedhur të aplikojë SKK 11 "Tatimi mbi fitimin" për njohjen e tatimit të shtyrë

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **k. Pagesat e qirasë**

Pagesat e qirasë operative njihen si shpenzime, duke përdorur metodën lineare përgjatë afatit të qirasë. Pagesat minimale të qirasë financiare ndahen në shpenzime financiare dhe pakësime të detyrimit të mbetur. Shpenzimet financiare shpërndahen gjatë afatit të qirasë me qëllim që të përfitohet një normë interesi periodike e qëndrueshme mbi gjendjen e mbetur të detyrimit.

#### **3.1 VLERËSIMET E RËNDËSISHME KONTABËL**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme, nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacioni për elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare përshkruhen në shënimet shpjeguese të mëposhtme. Përdorimi i supozimeve kontabël është minimal në pasqyrat financiare aktuale duke marrë parasysh thjeshtësinë e natyrës së operacioneve që kryen Shoqëria.

Vlerësimet janë përdorur, por jo të kufizuara, në:

- Jetën e amortizueshme dhe vlerën e mbetur të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale,
- Zbritjen për inventarët dhe borxhet e dyshimta, dhe
- Çështjet ligjore.

Ngjarjet e ardhshme dhe ndikimi i tyre nuk mund të perceptohen me siguri. Prandaj, vlerësimet kontabël të bëra kërkojnë ushtrimin e gjykimit dhe gjykimi i përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare do të ndryshojë me krijimin e ngjarjeve të reja, me fitimin e përvojës, me mbartjen e informacioneve shtesë dhe ndryshimin e mjedisit operues të Grupit. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Në vitin fiskal 2018, në përputhje me rregulloret e kontabilitetit, jeta e dobishme e aseteve fikse (përmirësimet në qira dhe mobilje) është modifikuar nëpërmjet azhornimit të analizës së kryer nga shoqëria mëmë në ushtrimet e mëparshme. Bazuar në analizën e lartpërmendur, Zara Holding BV ka përditësuar jetën e dobishme të aseteve të përmendura në 10.5 vjet që nga 1 janari 2018 (*shih notën 8*).

Supozimet kryesore lidhur me të ardhmen dhe burimet e tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në datën e bilancit, që mbartin një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material të vlerave kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit financiar të ardhshëm, janë diskutuar më poshtë.

**3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

**3.2 RIKLASIFIKIM I PREZANTIMIT TË VITIT TË MËPARSHËM**

Disa balanca të vitit të mëparshëm janë riklasifikuar për konsistencë me prezantimin e vitit aktual. Këto riklasifikime nuk kishin efekt në rezultatet e raportuara. Balancat janë korrigjuar duke riklasifikuar secilin nga zërat e pasqyrave financiare në vitin e mëparshëm dhe janë përshkruar si më poshtë:

<i>Pasqyra e pozicionit financiar</i>	<b>Impakti i riklasifikimit të balancave kontabël</b>		
	<b>Raportuar më parë</b>	<b>Shuma e riklasifikuar</b>	<b>Riklasifikuar</b>
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>			
Llogari të pagueshme	59,694	76,406	136,100
Detyrime të tjera	149,468	(76,406)	73,062
<b>Impakti neto</b>		-	

*Riklasifikimi i shumës (76,406 mijë Lek) lidhet me llogaritë e pagueshme ndaj palëve të treta, të cilat ishin të klasifikuara si detyrime të tjera në vitin e mëparshëm.*



#### **4. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF)**

##### **4.1 STANDARDET DHE INTERPRETIME EFEKTIVE NË PERIUdhËN AKTUALE**

Ndryshimet e standarteve ekzistuese si më mëposhtë, të lëshuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e lëshuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimit Financiar janë efektive për periudhën aktuale.

- **SNRF 9 – Instrumentat Financiare**

SNRF 9 zëvendëson SNK 39 që nga 1 janari 2018, në lidhje me të cilat ka dallime shumë të rëndësishme në lidhje me klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, modelin e zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe në kontabilitetin mbrojtës. Në këtë kuptim, ajo ka prezantuar ndryshime në aspektet e mëposhtme:

*Klasifikimi dhe matja e instrumenteve financiare:* Në lidhje me aktivet financiare, Politika e Investimeve të Shoqërisë përcakton që qëllimi i përgjithshëm i modelit të biznesit të Shoqërisë në lidhje me aktivet financiare është ruajtja e principalit nëpërmjet zbutjes së rrezikut të humbjes së investimit kapital që rrjedh nga çdo lloj rreziku. Prandaj, modeli i biznesit i Shoqërisë ka për qëllim mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale të aktiveve financiare që janë ekskluzivisht principali dhe interesi. Rrjedhimisht, me SNRF 9, aktivet financiare të Shoqërisë brenda objektit të këtij standardi klasifikohen si të vlerësuara me koston e tyre të amortizuar, me përjashtim të faturave, të cilat vlerësohen me vlerën e tyre të drejtë. Në lidhje me detyrimet financiare, bazat e miratuara me SNK 39 vazhdojnë të maten në të njëjtën bazë.

Prandaj, zbatimi i SNRF 9 nuk ka pasur një ndikim të rëndësishëm në matjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare.

Shoqëria nuk ka rinegociuar detyrimet e saj financiare; prandaj ky aspekt i SNRF 9 nuk ka ndikim në pasqyrat financiare statutoare.

*Zhvlerësimi:* Matja e zhvlerësimit të aktiveve financiare me koston e amortizuar me SNRF 9 bazohet në humbjen e pritshme. Për këtë qëllim, Shoqëria ka përcaktuar një model për të vlerësuar periodikisht, së pari, nëse ka pasur ndryshime të rëndësishme në rrezikun e kreditorit të palëve të mjeteve financiare për, më pas, me kusht që rreziku kreditor është i ulët ose nuk është rritur, humbja e pritshme në 12 muaj.

Në datën e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare për aktivet financiare që janë brenda objektit të modelit të humbjes së pritshme, Menaxhmenti i Grupit konsideron që rreziku kreditor është i ulët në datën e vlerësimit ose nuk është rritur ndjeshëm që nga data e njohjes fillestare, pra, humbjet e kreditit që priten në 12 muaj janë njohur.

Si rezultat i zbatimit të kësaj metodologjie, shuma e zhvlerësimit për humbjen e vlerësuar të aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar nuk është e rëndësishme ose dallon shumë nga shuma që do të ishte njohur nëse do të ishte zbatuar modeli i humbjes nga zhvlerësimi i krijuar në SNK 39.

*Kontabiliteti mbrojtës:* Zbatimi i kërkesave të reja për kontabilitetin mbrojtës nuk ka pasur efekt në pasqyrat financiare të vitit 2018 pasi që Grupi nuk ka përcaktuar marrëdhënie të reja mbrojtëse që nuk ishin të mundshme sipas SNK 39 dhe raportet e mbrojtjes të përcaktuara sipas SNK 39 vazhdojnë të plotësojnë kërkesat për kontabilitetin mbrojtës.

Shoqëria zbaton SNRF 9 që nga 1 janari 2018 pa rishqyrtuar shifrat krahasuese.

#### 4. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF)

##### 4.1 STANDARDET DHE INTERPRETIME EFEKTIVE NË PERIUHDHËN AKTUALE

- **SNRF 15 – Të ardhura nga kontratat me klientët**

SNRF 15 është standardi gjithëpërfshirës për njohjen e të ardhurave nga klientët dhe vendos një metodë të njohjes së të ardhurave bazuar në transferimin e kontrollit, për të cilin përcakton një model me 5 hapa:

Hapi 1: identifikoni kontratën ose kontratat me klientët

Hapi 2: Identifikoni detyrimet e këtyre kontratave

Hapi 3: Përcaktoni çmimin e transaksionit

Hapi 4: Alokimi i çmimit të transaksionit ndaj detyrimeve në kontratë

Hapi 5: Njohja e të ardhurave kur njësia ekonomike përmbush secilën nga detyrimet

Shoqëria ka aplikuar standardin në mënyrë retroaktive, pa rishqyrtuar informacionin krahasues, që nga 1 janari 2018.

Të ardhurat e Shoqërisë vijnë nga pothuajse të gjitha shitjet me pakicë përmes dyqaneve të veta dhe dyqaneve online. Detyrimet e kontraktuara në këto aktivitete korrespondojnë, në thelb, me dërgimin e mallrave të caktuara për klientët. Këto detyrime janë të ndara nga njëri-tjetri, dmth., nuk ka kontrata ku detyrimet e performancës janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Prandaj, çmimi i caktuar për secilin nga detyrimet përputhet me çmimin e pavarur të shitjes. Në anën tjetër, në praktikisht të gjitha transaksionet e të ardhurave të Shoqërisë, detyrimet përmbushen në një moment të vetëm (kur mallrat dorëzohen tek klienti), kështu që nuk ka detyrime që plotësohen me kalimin e kohës. Për të gjitha sa më sipër, modeli i Shoqërisë për njohjen e të ardhurave sipas SNRF 15 nuk ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga modeli i të ardhurave sipas SNK 18 dhe efekti në pasqyrat financiare statutores që rrjedhin nga zbatimi i SNRF 15 nuk është relevant.

Nga ana tjetër, Shoqëria nuk ka njohur aktivet ose detyrimet që rrjedhin nga kontratat me klientët për zbatimin e SNRF 15.

- **Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesa bazuar në aksione"** - Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit"** - Zbatimi i SNRF 9 "Instrumentat Financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e Sigurimeve" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentet Financiare" aplikohet për herë të parë),
- **Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Afatgjata Materiale të Investuara"** - Transferimet e Aktivit Afatgjatë të Investuar (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe qartësimin e formulimit (ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **IFRIC 22 "Transaksionet në valutë dhe Konsiderata për Avancat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Adoptimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

#### **4. APLIKIMI I STANDARTEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF)**

##### **4.2. STANDARDET DHE NDRYSHIMET E PUBLIKUARA QË NUK JANË ADOPTUAR ENDE**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri ishin publikuar, por ende jo efektive:

- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),

SNRF 16 "Qiratë", zëvendëson SNK 17, si dhe të gjitha interpretimet përkatëse. SNRF 16 do të hyjë në fuqi për Shoqërinë më 1 janar 2019.

SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të qirasë. Sipas SNRF 16, qiramarrësit duhet të regjistrojnë të gjitha qiratë sipas një modeli të vetëm të ngjashëm me kontabilitetin e qirasë financiare në SNK 17. Qiramarrësit do të njohin një pasiv për vlerën aktuale neto të pagesave të qirasë dhe një aktiv për të drejtën e përdorimit të aktivitet bazë gjatë afatit të qirasë.

Po ashtu, natyra e shpenzimeve që lidhen me qiratë në fjalë do të ndryshojnë, pasi që SNRF 16 zëvendëson shpenzimet e drejtpërdrejta të qirasë operative për shpenzimet që rrjedhin nga amortizimi i aktivitet të njohur dhe me një shpenzim interesi të lidhur me detyrimin.

Qiramarrësi mund të zgjedhë që të mos zbatojë kriteret e përgjithshme të SNRF 16 për qiratë afatshkurtëra dhe qiratë, pasuritë e të cilave janë konsideruar të jenë me vlerë të ulët. Shoqëria do të zbatojë vetëm përjashtimin për qira, pasuria e të cilës është konsideruar të jetë me vlerë të vogël.

Zbatimi i SNRF 16 kërkon gjykime të rëndësishme në lidhje me vlerësime të caktuara kryesore, të tilla si përcaktimi i afatit të qirasë dhe norma e skontimit.

Për të përcaktuar afatin e qirasë, duhet të vlerësohet nëse qiramarrësi ka siguri të arsyeshme se ai do të ushtrojë mundësinë për të zgjatur një kontratë qiraje ose se ai nuk do të ushtrojë mundësinë për të përfunduar qiramarrjen. Shoqëria do të përcaktojë afatin e qirasë si periudhë të parëvokueshme të qirasë plus ato opsione të njëanshme për zgjatjet mbi të cilat ekziston një siguri e arsyeshme e ekzekutimit, për të cilat merren parasysh aspektet e mëposhtme:

- Kostot që lidhen me ndërprerjen e kontratës,
- Rëndësia e aktivitet të dhënë me qira për veprimtarinë e Shoqërisë,
- Kushtet që duhet të përmbushen në mënyrë që opsionet të mund të ushtrohen ose jo,
- Përvoja historike dhe planet e biznesit të miratuara nga menaxhmenti i Grupit që i përket Shoqëria.

Vlera aktuale e pasivit të dhënë me qira është përcaktuar duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qiranë dhe nëse kjo nuk mund të përcaktohet lehtësisht, qiramarrësi do të përdorë normën e saj të huamarrjes shtesë. Duke pasur parasysh vështirësinë për të përcaktuar normën e interesit të nënkuptuar të çdo qiraje, Shoqëria do të përdorë normën e saj të huamarrjes shtesë sipas afateve dhe monedhës.

Nga ana tjetër, SNRF 16 lejon zbatimin e saj nëpërmjet dy metodave të ndryshme të tranzicionit, një qasje retrospektive për çdo periudhë krahasuese të paraqitur ose një qasje retrospektive me efektin kumulativ të zbatimit fillestar të standardit të njohur si një rregullim në bilancet fillestare të fitimet e pashpërndara në datën e aplikimit fillestar. Shoqëria ka vendosur të miratojë këtë metodë të dytë të tranzicionit, prandaj do të njohë efektin kumulativ të aplikimit fillestar si një rregullim ndaj rezervave që nga 1 janari 2019 dhe nuk do të rishqyrtojë informacionin krahasues.

Kjo metodë e tranzicionit lejon, nga ana tjetër, të zgjedhë të vlerësojë aktivin në mënyrë retroaktive sikur standardi të ishte zbatuar që nga fillimi i qirasë ose për një shumë të barabartë me detyrimet e rregulluara për pagesat me parapagesë ose të përllogaritur.

#### 4. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF) (VAZHDIM)

##### 4.2 STANDARDET DHE INTERPRETIMET E PUBLIKUARA QË NUK JANE ADOPTUAR ENDE (VAZHDIM)

- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019) (vazhdim)

Për më tepër, Shoqëria do të zbatojë disa nga thjeshtimet që lidhen me metodën e tranzicionit të miratuar. Më të rëndësishmet janë:

- përjashtimi i kostove fillestare të drejtpërdrejta të matjes së pasurisë së drejtës së përdorimit në datën e kalimit;
- aplikimi i një norme të vetme të skontimit për çdo portofol të qirasë të ngjashme, sipas termave dhe monedhës;
- përcaktimin e afatit të qirasë duke përdorur retrospektivë;
- mos-rishikimin e zhvlerësimit të vlerës në datën e tranzicionit.

Shumica e dyqaneve të Shoqërisë janë të vendosura në ambientet e marra me qira të cilat janë rregjistruar nën qira operationale. Të dy këto angazhime dhe marrëveshje të tjera të lidhura nga Shoqëria përbushin përkufizimin e qirasë sipas SNRF 16 dhe kërkojnë njohjen e një aktivi për të drejtën e përdorimit dhe detyrimin përkatës. Nga analiza e kryer deri më sot, Shoqëria vlerëson se më 1 janar 2019 do të njohë një detyrim qiraje për një shumë prej 60,570 dhe 64,320 mijë Lekë.

Shoqëria është në një fazë shumë të avancuar të projektit të zbatimit të kritereve të reja të kontabilitetit, megjithatë, ndikimet që nga 1 janari 2019 mund të jenë paksa të ndryshme për shkak të vlerësimeve të kërkuara, numrit të lartë të kontratave të prekura dhe se Shoqëria është në procesin e testimit të sistemeve të reja të IT. Politikata e reja kontabël nuk do të jenë përfundimtare deri sa Shoqëria të paraqesë pasqyrat e para financiare pas datës së hyrjes në fuqi të SNRF 16.

- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021),
- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiarë"** - Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Shitja ose kontributi i aktiveve midis një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar deri në projektin kërkimor metoda e kapitalit është përfunduar),
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet"** - Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020)
- **Ndryshimet në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"** - Ndryshimi i planit, shkurtimi ose shlyerja (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019),

Shoqëria beson se adaptimi i standardeve të reja, rishikimeve dhe interpretimeve, me përjashtim të SNRF 16, nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën fillestare të aplikimit.

## 5. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTËT E TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre janë si më poshtë :

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
<b>Para në arkë</b>	<b>9,576</b>	<b>41,461</b>
Lek	8,149	36,864
Monedhë e huaj	1,427	4,597
<b>Para në bankë</b>	<b>372,135</b>	<b>605,659</b>
Lek	355,237	600,742
Monedhë e huaj	16,898	4,917
<b>Para ne tranzit</b>	<b>20,825</b>	<b>16,827</b>
<b>Totali</b>	<b>402,536</b>	<b>663,947</b>

Mjetet monetare në tranzit lidhen me paratë mbledhura nga shitjet e ditëve të fundit të vitit 2018, të cilat reflektohen në deklaratën bankare në ditët e para të vitit 2019.

## 6. INVENTARI

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Produkt i gatshëm	350,348	282,604
Provizjione për zhvlerësime	(73,094)	(69,469)
<b>Totali</b>	<b>277,254</b>	<b>213,135</b>

Inventari paraqitet me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
<b>Levizjet në zhvlerësim</b>		
Balanca hapëse	(69,469)	(50,093)
Zhvlerësimi i vitit	(3,624)	(19,376)
Rimarrje e provigjonit	-	-
<b>Totali</b>	<b>(73,093)</b>	<b>(69,469)</b>

**7. AKTIVE TË TJERA AFATSHKURTRA**

Aktivitet e tjera më 31 dhjetor 2018 and 2017 përbëhen si me poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Më 31 dhjetor 2017</b>
Të arkëtueshme nga GOA Invest	17,304	-
Tatim fitimi	-	1,641
Paradhënie të tjera	6,633	6,025
<b>Totali</b>	<b>23,937</b>	<b>7,666</b>

Shoqëria është një përfaqësues tatimor i GOA Invest në Shqipëri. Shuma e arkëtueshme nga GOA Invest lidhet me disa pagesa të bëra nga Shoqëria tek autoritetet doganore në favor të GOA Invest ("Shoqëri e Grupit") në lidhje me punimet që ky i fundit ka bërë për disa dyqane.

**ITX Albania SHPK**  
**Shënime mbi pasqyrat financiare**  
*(Shumat janë shprehur në mijë LEK)*

**8. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

	Përmirësimet e ambjentëve me qira	Mobilje dhe pajisje	Pajisje komputerike	Aktive të tjera	Aktive të tjera në progres	Totali
<i>Kosto</i>						
<b>Gjendja në 31 dhjetor 2017</b>	<b>796,081</b>	<b>271,682</b>	<b>42,764</b>	<b>3,172</b>	<b>4,678</b>	<b>1,118,377</b>
Shtesa	285,642	90,872	22,403	6,665	4,823	410,405
Pakësime	28,205	45	103	69	4,678	33,100
<b>Gjendja në 31 dhjetor 2018</b>	<b>1,053,518</b>	<b>362,509</b>	<b>65,064</b>	<b>9,768</b>	<b>4,823</b>	<b>1,495,682</b>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>						
<b>Gjendja në 31 dhjetor 2017</b>	<b>320,591</b>	<b>98,745</b>	<b>24,127</b>	<b>1,105</b>	-	<b>444,568</b>
Amortizimi i vitit	78,272	27,176	9,216	449	-	115,113
Pakësime	28,205	45	103	45	-	28,398
<b>Gjendja në 31 dhjetor 2018</b>	<b>370,658</b>	<b>125,876</b>	<b>33,240</b>	<b>1,509</b>	-	<b>531,283</b>
<i>Vlera e mbetur</i>						
<b>Gjendja në 31 dhjetor 2017</b>	<b>475,490</b>	<b>172,937</b>	<b>18,637</b>	<b>2,067</b>	<b>4,678</b>	<b>673,809</b>
<b>Gjendja në 31 dhjetor 2018</b>	<b>682,860</b>	<b>236,633</b>	<b>31,824</b>	<b>8,259</b>	<b>4,823</b>	<b>964,399</b>

Vlerat që kanë të bëjnë me përmirësimet e qirasë janë kryesisht të lidhura me punimet e kryera nga Shoqëria në dyqanet e huazuara ku kryhet veprimtaria. Mobiljet dhe pajisjet janë të lidhura me mobiljet e reja të blera për dyqanet dhe zyrën. Pakësimet e aktiveve lidhen me aktivet e amortizuara plotësisht në vitet e fundit sidomos me përmirësimet e qirasë për zyrën qendrore (gips, pikturë, instalime elektrike, kablllove të brendshme).

Asnjë aktiv afatgjatë material nuk është lënë kolateral si më 31 dhjetor 2018 (2017: asnjë)

## 9. AKTIVE TATIMORE TË SHTYRA

Shoqëria ka aktive të shtyra tatimore të lidhura me diferencën që vjen nga aplikimi i normave të ndryshme të amortizimit për qëllime fiskale dhe statutore. Shuma i është zbritur tatim fitimit të vitit. Për detaje të mëtejshme ju lutem shikoni shenimin 17.

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Aktive tatimore te shtyra	27,544	21,556
<b>Total</b>	<b>27,544</b>	<b>21,556</b>
	<b>2018</b>	<b>2017</b>
<b>Balanca hapëse më 1 janar</b>	<b>21,556</b>	<b>15,808</b>
Tatimi i shtyrë	5,988	5,747
<b>Balanca mbyllëse më 31 dhjetor</b>	<b>27,544</b>	<b>21,556</b>

## 10. LLOGARITË E PAGUESHME

Vlerat e lidhura me llogaritë e pagueshme tregtare janë drejt kompanive të grupit dhe janë të lidhura me blerjen e produkteve të gatshme që Shoqëria ka kryer për aktivitetin e saj.

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Furnitoret e grupit ITX	45,248	39,485
Furnitoret e grupit ITX – fatura për tu marrë	6,836	20,208
Grupi ITX - Provigjoni për kthimet	3,798	-
<b>Llogaritë e pagueshme të furnitorëve të grupit ITX</b>	<b>55,882</b>	<b>59,693</b>
Furnitorët vendas	93,549	75,442
Furnitorët e huaj	829	964
<b>Llogaritë e pagueshme- Palët e treta</b>	<b>94,378</b>	<b>76,406</b>
<b>Totali i llogarive të pagueshme</b>	<b>150,260</b>	<b>136,099</b>

## 11. TË ARDHURAT E SHTYRA

Të ardhurat e shtyra janë të lidhura me tarifat e hyrjes për dhënien me qira të dyqaneve. Shuma është regjistruar fillimisht si e ardhur e shtyrë dhe amortizohet gjatë jetës së qirasë si një zbritje e shpenzimeve vjetore të qirasë.

Të ardhurat e shtyra afatshkurtra dhe afatgjata janë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Të ardhura të shtyra afatshkurtra	32,269	29,670
Të ardhura të shtyra afatgjata	310,180	304,118
<b>Totali</b>	<b>342,449</b>	<b>333,788</b>



## 12. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
TVSH e pagueshme	33,605	33,468
Tatimi mbi fitimin i pagueshëm	16,914	18,238
Detyrime ndaj punonjësve	13,757	6,796
Taksa të tjera të pagueshme	7,820	8,092
Kreditorë të tjerë	6,138	6,468
<b>Totali</b>	<b>78,234</b>	<b>73,062</b>

## 13. TË ARDHURA NGA SHITJET

Të ardhura nga shitjet përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shitje veshjesh	2,891,699	2,707,496
Shitje këpucësh	323,844	334,979
Shitje parfumesh dhe produktesh kozmetike	29,138	30,091
Shitje për shtëpinë	57,615	-
Shitje të tjera	8,718	-
Provizjon për kthimet e veshjeve	(3,798)	-
Zbritje për punonjësit	(12,366)	(10,885)
<b>Totali</b>	<b>3,294,850</b>	<b>3,061,681</b>

Shitjet për produktet shtëpiake i referohen të ardhurave të gjeneruara nga dyqani i ri Zara Home i hapur gjatë 2018.

## 14. TË ARDHURA TË TJERA

Të ardhurat e tjera janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Kosto e zënies-nxitjet e qirasë	30,320	29,670
Të ardhura të tjera operative	1,219	606
<b>Totali</b>	<b>31,539</b>	<b>30,276</b>

*Kosto e zënies-nxitjet e qirasë është pjesë e stimujve të qirasë që amortizohet në të ardhurat për vitin aktual.*

**15. SHPENZIME PERSONELI**

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>
Paga bruto	152,463	143,424
Sigurimet shoqërore	22,664	20,718
<b>Totali</b>	<b>175,127</b>	<b>164,141</b>

**16. SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE**

Shpenzimet e tjera operative përbëhen si më poshtë:

		<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>
Honorare	16.1	199,801	189,761
Qira	16.2	197,265	178,601
Energji elektrike		32,850	31,117
Shpenzime të tjera operative		27,112	24,551
Komisione Bankare		14,303	12,673
Shërbime ndaj Grupit		6,992	11,366
Dekorim për dyqanet		2,773	3,718
Premium sigurimi		2,251	1,815
Të tjera		34,750	26,741
<b>Totali</b>		<b>518,097</b>	<b>480,343</b>

**16.1 Honoraret**

Honoraret lidhen me pagesat e kostove vairabël që Shoqëria ka për të paguar tek ITX Merken B.V.

**16.2 Shpenzime qiraje**

Shpenzimet e qirasë janë të lidhura me qiranë fikse dhe të ndryshueshme që paguan në lidhje me tetë dyqanet që zotëron, gjashtë dyqane në TEG dhe dy dyqane në QTU. Kohëzgjatja e marrëveshjeve të qirasë është 15 vjet. Gjatë vitit 2018, janë hapur tre dyqane të reja, Zara Home në TEG dhe Stradivarius dhe Bershka në QTU. Dyqanet e tjera janë hapur që nga prilli i vitit 2014.

**17. HUMBJE NGA KURSI I KËMBIMIT**

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>
Fitim nga kursi i këmbimit	18,554	5,372
Humbje nga kursi i këmbimit	(22,803)	(9,795)
<b>Humbje nga kursi i këmbimit</b>	<b>(4,249)</b>	<b>(4,423)</b>

**18. TATIM MBI FITIMIN**

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri është vlerësuar në normën 15% (2017:15%) i të ardhurave të tatueshme. Në vijim është bërë një rakordim i tatimit mbi fitimin.

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>
Fitimi para tatimit	854,251	753,199
Shpenzime të pazbritshme	49,161	58,677
Fitimitimi i tatueshëm	903,412	811,876
Norma e tatim fitimit	15%	15%
<b>Shpenzimi për tatim fitimin</b>	<b>135,512</b>	<b>121,781</b>
Tatimi i shtyrë nga diferencat e përkohëshme në zhvlerësim	(5,988)	(5,747)
<b>Shpenzimi i tatim fitimit neto</b>	<b>129,524</b>	<b>116,034</b>
<b>Norma e tatimit efektiv</b>	<b>15%</b>	<b>15%</b>

Pozicionet e pasigurta tatimore të Shoqërisë rishqyrtohen nga Drejtimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat të cilat përcaktohen nga Drejtimi, pasi ka më shumë gjasa që të mos rezultojë në vendosjen e taksave shtesë nëse pozitat do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose miratuar në mënyrë të pavarur deri në fund të periudhës raportuese, në çdo gjykatë të njohur ose vendime të tjera për çështje të tilla. Detyrimet për penalitetet, interesat dhe tatimet tjera nga të ardhurat njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit të shpenzimeve të nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese.

**ITX Albania SHPK**  
**Shënime mbi pasqyrat financiare**  
*(Shumat janë shprehur në mijë LEK)*

**19. PALËT E LIDHURA**

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim. Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike; ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influencë të konsiderueshme mbi njësinë; ose pala ushtron një kontroll të përbashkët mbi njësinë; pala është një pjesëmarrje e njësisë ekonomike; pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi ekonomike është një sipërmarrës; ose një nga anëtarët e personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër).

Më poshtë paraqiten palët e lidhura të Shoqërisë dhe balancat përkatëse më 31 dhjetor 2018 dhe 2017:

<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>	<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Më 31 dhjetor 2017</b>
<b>Llogari të pagueshme</b>		
Itx Merken B.V	(12,173)	(17,106)
Industria De Diseno Textil Sa	(19,116)	(13,549)
Goa-Invest S.A.	-	(10,416)
Grupo Massimo Dutti Sa	(4,218)	(6,015)
Bershka Bsk Espana Sa	(5,208)	(4,497)
Stradivarius Espana Sa	(5,402)	(3,406)
Tempe Sa	(3,557)	(2,883)
Pull & Bear Espana, S.A.	(2,604)	(1,595)
Zara Croatia, L.T.D	(101)	(226)
Zara Home Espana S.A	(858)	-
ITX Merken B.V. Fribourg Branch	(67)	-
ITX Kosovo L.L.C	969	-
Bershka BH D.O.O.	251	-
<b>Totali</b>	<b>(52,084)</b>	<b>(59,693)</b>
<b>Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve</b>		
	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>
<b>Blerje e produkteve për shitje</b>		
Industria De Diseno Textil Sa	890,155	868,726
Bershka Bsk Espana Sa	184,831	177,835
Tempe S.A	183,536	174,527
Grupo Massimo Dutti Sa	154,922	150,885
Pull & Bear Espana, S.A.	127,197	117,573
Stradivarius Espana Sa	102,803	91,267
Zara Home Espana S.A.	19,907	-
<b>Totali i shpenzimeve me palët e lidhura</b>	<b>1,663,351</b>	<b>1,580,813</b>

**20. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR**

**a) Rreziku i likuiditetit**

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2018 është paraqitur si më poshtë:

	<b>Vlera e mbartur</b>	<b>Deri në 6 muaj</b>	<b>6-12 muaj</b>	<b>Më shumë se 1 vit</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>				
<b>Aktive financiare</b>				
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	402,536	402,536	-	-
Aktive të tjera afatshkurtra	23,937	6,632	17,304	-
<b>Totali</b>	<b>426,473</b>	<b>409,168</b>	<b>17,304</b>	<b>-</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Llogari të pagueshme	(150,260)	(150,260)	-	-
Të ardhura të shtyra	(342,449)	-	(32,269)	(310,180)
<b>Totali</b>	<b>(492,709)</b>	<b>(150,260)</b>	<b>(32,269)</b>	<b>(310,180)</b>
<b>Pozicioni neto i likuiditetit</b>	<b>(66,236)</b>	<b>258,908</b>	<b>(14,964)</b>	<b>(310,180)</b>

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2017 është paraqitur si më poshtë:

	<b>Vlera e mbartur</b>	<b>Deri në 3 muaj</b>	<b>6-12 muaj</b>	<b>Më shumë se 1 vit</b>
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>				
<b>Aktive financiare</b>				
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	663,947	663,947	-	-
Aktive të tjera afatshkurtra	7,666	6,025	1,641	-
<b>Totali</b>	<b>671,613</b>	<b>669,972</b>	<b>1,641</b>	<b>-</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Llogari të pagueshme	(136,099)	(136,099)	-	-
Të ardhura të shtyra	(333,788)	-	(29,670)	(304,118)
<b>Totali</b>	<b>(469,888)</b>	<b>(136,100)</b>	<b>(29,670)</b>	<b>(304,118)</b>
<b>Pozicioni neto i likuiditetit</b>	<b>201,726</b>	<b>533,873</b>	<b>(28,029)</b>	<b>(304,118)</b>

**20. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**b) Rreziku i kursit të këmbimit**

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	Vlera e mbartur	Euro	Lek
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>			
<i><b>Aktive Financiare</b></i>			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	402,536	18,325	384,211
Aktive të tjera afatshkurtra	23,937	-	23,937
<b>Totali</b>	<b>426,473</b>	<b>18,325</b>	<b>408,148</b>
<i><b>Detyrime financiare</b></i>			
Llogari të pagueshme	(150,260)	(56,711)	(93,549)
Të ardhura të shtyra	(342,449)	-	(342,449)
<b>Totali</b>	<b>(492,709)</b>	<b>(56,711)</b>	<b>(435,998)</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>(66,236)</b>	<b>(38,386)</b>	<b>(27,850)</b>

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

	Vlera e mbartur	Euro	Lek
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>			
<i><b>Aktive Financiare</b></i>			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	663,947	9,514	654,433
Aktive të tjera afatshkurtra	7,666	-	7,666
<b>Totali</b>	<b>671,613</b>	<b>9,514</b>	<b>662,099</b>
<i><b>Detyrime financiare</b></i>			
Llogari të pagueshme	(136,099)	(60,657)	(75,442)
Të ardhura të shtyra	(333,788)	-	(333,788)
<b>Totali</b>	<b>(469,888)</b>	<b>(60,657)</b>	<b>(409,231)</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>201,725</b>	<b>(51,143)</b>	<b>252,868</b>

*Analiza e ndjeshmërisë ndaj ndryshimit të kurseve të këmbimit*

Analiza e ndjeshmërisë e paraqitur më poshtë është përcaktuar në bazë të ekspozimit në valutë të huaj në datën e raportimit dhe ndryshimeve të përcaktuara të ndodhura në fillim të vitit financiar dhe duke mbajtur konstant gjatë periudhës raportuese. Më poshtë paraqiten ndikimet e ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi fitimin neto, duke mbajtur të pandryshueshëm të gjithë variablat e tjerë.

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR zhvlerësohet me 10%	3,839	5,114
EUR zhvlerësohet me 10%	(3,839)	(5,114)

**20. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**c) Rreziku kreditor**

Rreziku kreditor, është rreziku i humbjes financiare së Shoqërisë, nëse një klient ose një palë tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale, dhe vjen kryesisht nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre.

Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë, përfaqësohet nga vlera kontabël e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar, e paraqitur në tabelën më poshtë:

<i>Klasat e aktiveve financiare – vlerat e mbetura</i>	<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Më 31 dhjetor 2017</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	402,536	663,947
Aktive të tjera afatshkurtra	23,937	7,666
<b><u>Vlera kontabës</u></b>	<b><u>426,473</u></b>	<b><u>671,613</u></b>

Tabela mëposhtë paraqet ekspozimin e riskut e kredisë ndaj kundërpative dhe falimentimit apo zhvlerësimeve të lidhura, nëse ka:

	<b>Më 31 dhjetor 2018</b>		<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	
	<b>Bruto</b>	<b>Zhvlerësimi</b>	<b>Bruto</b>	<b>Zhvlerësimi</b>
<i>As me vonesë dhe as të zhvlerësuara</i>				
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	402,536	-	663,947	-
Aktive të tjera afatshkurtra	23,937	-	7,666	-
<b><u>Totali</u></b>	<b><u>426,473</u></b>	<b><u>-</u></b>	<b><u>671,613</u></b>	<b><u>-</u></b>
<i>Në vonesë dhe të pa zhvlerësuara sipas kërkesave të SNRF 9</i>				
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	-	-	-	-
Aktive të tjera afatshkurtra	-	-	-	-
<b><u>Totali</u></b>	<b><u>-</u></b>	<b><u>-</u></b>	<b><u>-</u></b>	<b><u>-</u></b>
<i>Në vonesë dhe të zhvlerësuara</i>				
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	-	-	-	-
Aktive të tjera afatshkurtra	-	-	-	-
<b><u>Totali</u></b>	<b><u>426,473</u></b>	<b><u>-</u></b>	<b><u>671,613</u></b>	<b><u>-</u></b>

**20. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**d) Vlerësimi i vlerës së drejtë**

Matjet e vlerës së drejtë analizohen për nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë si vijon: niveli i parë është një matje (jo e rregulluar) e çmimeve në tregjet aktive për të njëjtat aktive ose detyrime, (ii) teknikat e vlerësimit të matjeve të nivelit të dytë me të gjitha materialet aktivet që i atribuohen drejtpërdrejt asetit ose detyrimit (dmth. si çmime) ose indirekt (dmth., rrjedhim nga çmimet), dhe (iii) niveli i tre matjeve janë vlerësime që nuk bazohen në të dhënat e vëzhguara në tregu (jo inputime të vëzhguara). Drejtimi aplikon gjykimin për kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë.

Vlerat e drejta të analizuara nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë dhe vlerat kontabël neto të aktiveve jo të matura me vlerën e drejtë janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018			Totali
	Vlera e drejtë Niveli i parë	Vlera e drejtë Niveli i dytë	Vlera e drejtë Niveli i tretë	
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	402,536	-	-	402,536
Aktive të tjera afatshkurtra	-	-	23,937	23,937
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	-	-	150,260	150,260
	31 dhjetor 2017			
	Vlera e drejtë Niveli i parë	Vlera e drejtë Niveli i dytë	Vlera e drejtë Niveli i tretë	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	663,947	-	-	663,947
Aktive të tjera afatshkurtra	-	-	7,666	7,666
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	-	-	136,100	136,100

*Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*

Në zërin mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj bëjnë pjesë vetëm paratë dhe llogaritë rrjedhëse në bankë. Duke qënë se këto balanca kanë afat të shkurtër dhe janë me norma interesi të ndryshueshme, vlera e drejtë e tyre është pothuajse e barabartë me vlerën kontabël.

*Llogari të arkëtueshem dhe të tjera*

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshem dhe të tjera është afërsisht sa vlera e tyre e drejtë për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër.

*Llogari të pagueshme dhe të tjera*

Vlera e drejtë e llogarive të pagueshme dhe të tjera është afërsisht sa vlera e tyre e drejtë për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër.



**21. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA**

Gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime ose veprime ligjore të palëve të treta. Bazuar në opinionin e manaxhimit të Shoqërisë, përfundimi përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekt në pozitën financiare të Shoqërisë ose nuk do të sjellë ndryshime në asete. Më 31 dhjetor 2018 kompania ka marrëveshje operative të qirasë për të gjitha dyqanet dhe zyrën. Nuk ka angazhime dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2018.

**22. NGJARJE PAS DATES SË RAPORTIMIT FINANCIAR**

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit për të cilat nevojiten rregullime apo shënime shpjeguese në këto pasqyra financiare.